

AKT THEMELIMI
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"S.E.T.A GROUP" SHPK

Sot, më datë 07/05/2018, ortakët si më poshtë:

1. **Z. Igli Amaolo**, shtetas italian, lindur me 16.06.1969, në Civitanova Marche', (MC), dhe banues në Tiranë në adresën: Rruga: "AsimVokshi", Pall. 141, Shkalla 1, Ap. 9, Kati 5, Tiranë, identifikuar me Kartën e Identitetit me Nr. AX 3862254.
2. **Z. Ersi Sulejmani**, shtetas shqiptar, lindur më 29.07.1980 në Tiranë dhe banues në adresën: Rruga "Emin Duraku", Apartamenti Nr. 5, Hyrja 1, Tiranë, identifikuar me Letërnjoftim ID me Nr. I05729105G Personal;

Vendosën të hartojnë këtë Akt Themelimi, me përmbajtje si më poshtë:

NENI 1

DATA E THEMELIT

Sot më datë 07/05/2018 themeluesit Igli Amaolo dhe Ersi Sulejmani, vendosën të krijojnë një shoqëri të quajtur "S.E.T.A GROUP" SHPK.

NENI 2

FORMA E SHOQËRISË

Kjo shoqëri do të jetë me përgjegjësi të kufizuar (SHPK) derisa të vendoset ndryshe për shndërrimin në një formë tjetër ligjore të parashikuar nga legjislacioni për shoqëritë tregtare.

NENI 3

EMËRTIMI

Emri i plotë i shoqërisë është "S.E.T.A GROUP" SHPK.

NENI 4

SELIA

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: "Kthesa e Prushit, 500 m përballë FNSH, Ndërtesë 4KT, Kati 1, Njësia Administrative Nr. 6, Tiranë.



Selia mund të zhvendoset në çfarëdo adresë tjetër, me miratim të organeve të saj. Shoqëria ka të drejtë të krijojë degë brenda dhe jashtë vendit në çdo moment që do ta gjykojë të nevojshme me anë të një vendimi të organit administrativ.

NENI 5

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë është për një periudhë të pacaktuar.

Shoqëria e fiton personalitetin juridik në datën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe nga kjo datë ajo mund të fillojë të ushtrojë aktivitetin tregtar deri në momentin kur me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të vendoset prishja e shoqërisë, ose kur shoqëria mbaron në një nga mënyrat e parashikuara në ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

NENI 6

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria "S.E.T.A GROUP," SHPK do të ketë si objekt të veprimtarisë:

Prodhimin e soletave për këpucë, shitje me shumicë dhe pakicë të komponentëve për këpucë. Dhënia e konsulences teknike lidhur me veprimtarinë e mësipërme. Ushtrimi i veprimtarisë së fasonerisë në bashkëpunim me shoqëri vendase dhe të huaja. Import dhe eksport i produkteve dhe aksesorëve për këpucë.

Çdo aktivitet tjetër tregtar që lidhet në mënyre të drejtëpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë dhe që është në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 7

KAPITALI

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 10.000 (dhjetë mijë) Lekë, i zotëruar plotësisht nga ortakët si më poshtë:

Emri	Perqindja %	Kuota (pjesë)	Vlera e pjesmarrjes
Igli Amaolo	50 %	1	5.000 (pesë mijë Lek)
Ersi Sulejmani	50 %	1	5.000 (pesë mijë Lek)

Ky kapital është i ndarë në 2 (dy) kuota të zotëruara nga dy ortakët.



Kapitali themeltar do të depozitohet ne një Bankë në Shqipëri, me një llogari të hapur në emër të shoqërisë në formim e sipër.

NENI 8

ADMINISTRATORI

Administratori i parë i shoqërisë "S.E.T.A GROUP" SHPK do të jetë:

Z. Igli Amaolo, shtetas italian, lindur me 16.06.1969, në Civitanova Marche', (MC), dhe banues në Tiranë në adresën: Rruga: "AsimVokshi", Pall. 141, Shkalla 1, Ap. 9, Kati 5, Tiranë, identifikuar me Kartën e Identitetit me Nr. AX 3862254.

Kohëzgjatja e mandatit të tij është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

NENI 9


DISPOZITA TË FUNDIT

Ky akt themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje, në gjuhën shqipe, me fuqi të njëjtë ligjore. Të dhënat tregtare të detyrueshme si dhe të dhënat e tjera për shoqërinë e sapokrijuar gjenden të detajuara në Statutin e shoqërisë bashkangjitur.

Autorizohet Administratori Z. Igli Amaolo për të kryer veprimet e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

THEMELUESIT

Igli Amaolo

IGLI AMAOLO


Ersi Sulejmani

Ersi Sulejmani
